



Sistemi detyrues i ftesës tek

# kontrollat për diktimin që në fillesë të fëmijëve

## Cila është detyra e Vëndit qëndror tek Charité?

Vëndi qëndror u ngarkua nga Senati me detyrën e zhvillimit të procedurës së ftesës dhe procedurës së përgjigjeve. Ai ka detyrën që të bëjë të sigurtë marrjen pjesë në kontrollat për diktimin që në fillesë. Për këtë ai duhet të provojë të dhëna të ndryshme:

- Të dhënat e fëmijëve të rregjistruar me rezidencën kryesore të banimit në Berlin, të cilët duhet të marrin pjesë në kontrollat, Vëndi qëndror i merr nga Zyra e Rregjistrimit të banorëve.
- Të dhënat e të sapolindurve me numrat e Screening-ID transmetohen nga laboratorit [Screening-Labor].
- Vëndi Qëndror merr vërtetimet e kontrollit nga pediatri dhe mjeku i të rinjve të Berlinit, i cili është i autorizuar dhe i detyruar, që t'ja transmetojë menjëherë Vëndit qëndror pjesëmarrjen në kontrollin e zhvilluar. Në qoftë se kontrolli zhvillohet jashtë vëndit Berlin, prindërit e fëmijës së kontrolluar nga mjeku duhet t'ja dërgojnë Vëndit qëndror një vërtetim të kontrollit.

Vëndi qëndror mund të shikojë nga këto të dhëna, se cilët fëmijë nuk janë kontrolluar akoma deri në një ditë të caktuar zyrtarisht. Ai i fton prindërit e fëmijëve, që të paraqesin fëmijët e tyre tek kontrolli, dhe informon për përmbajtjen dhe qëllimin e secilit kontroll.

Në qoftë se mbas kalimit të një afati të arsyeshëm, mbas dërgimit të ftesës nuk ka arritur asnjë vërtetim i kontrollit, Vëndi qëndror informon Shërbimin shëndetsor të fëmijëve dhe të rinjve (KJGD) për atë, se cilët fëmijë nuk janë kontrolluar akoma. Prindërve të tyre do t'ju ofrohet nga KJGD një vizitë në shtëpi dhe në rast nevojë këshillim dhe mbështetje.

Procedura është ndërtuar në atë mënyrë, që asnjë nga informacionet mjekësore të mos i transmetohet Vëndit qëndror. Procedura është bërë në marrëveshje me Komisionerin për Mbrojtjen e të dhënave të Berlinit [Berliner Datenschutzbeauftragter].

Të dashur prindër, të dashur të autorizuar për kujdestarinë, atëherë mos u çudisni, që qoftë se ju informoheni në lidhje me humbjen e një kontrolli për diktimin që në fillesë. Kuptojeni këtë ju lutemi si një kujtim ndihmues për një kontroll të dobishëm për fëmijën tuaj.

**Ne ju urojmë ju dhe fëmijës tuaj gjithë të mirat në të ardhmen!**

**Keni ju akoma pyetje?**

Internet i <http://rueckmeldewesen-kinderuntersuchungen.charite.de>  
[www.berlin.de/kindergesundheit](http://www.berlin.de/kindergesundheit)  
E-Mail [zentralestelle@charite.de](mailto:zentralestelle@charite.de)  
Telefon i 450 566 022



Albanisch  
Layout: Charité CFM Foto-Grafik-Video, A. Holm | Fotos: W. Peltz | CC17 | Kindervorsorgezentrum

Për mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve në Berlin





## Berlini fuqizon mbrojtjen e fëmijëve dhe shëndetin e fëmijëve

Çdo fëmi ka nevojë për një fillim të mirë në jetë. Shëndeti këtu është Alfa dhe Omega. Prandaj në Gjermani ekzistojnë për fëmijët një numër kontrollesh për diktimin që në fillësë, të cilat ndihmojnë për të kuptuar në kohë, çrregullime të zhvillimit dhe sëmundje. Kështu që mund të kryhen ndoshta në kohë mjekimet e nevojshme.

Ne duam ti japin të gjithë fëmijëve në Berlin shanse fillimi të mira dhe duam, që çdo fëmi të marrë pjesë në të gjitha kontrollet.

Prandaj Berlini ka miratuar një ligj për mbrojtjen e fëmijëve. Prindërit, të cilët nuk e kanë perceptuar me vullnet të lirë një kontroll për diktimin që në fillësë (U4-U9), do të ftohen, që të paraqesin fëmijën e tyre për kontroll.

## Pse është e rëndësishme një marrje pjesë pa mungesa në kontrollet?

Sepse me anë të kësaj, çrregullime të zhvillimit dhe sëmundje mund të kuptohen në kohë dhe mund të mjekohen po kështu. Disa çrregullime dhe sëmundje në lidhje me këtë janë të dukshme fillimisht mbas një moshe të caktuar, sipas kësaj janë caktuar momenti kohor dhe përmbajtja e çdo kontrolli të veçantë për diktimin që në fillësë. Edhe tek rezultatet që deri tani kanë dalë gjithmonë mirë është e rëndësishme për shkak të kësaj, që të respektohen të gjitha kontrollet.

Me rëndësi vendimtare janë përcaktimet në kohë të zhvillimeve të gabuara tek foshjet dhe fëmijët e vegjël, sepse vitet e para të jetës vendosin për një zhvillim të shëndetshëm të fëmijës. Por edhe për fëmijë më të rritur kontrollet preventive janë të rëndësishme.

Fëmijë, të cilët p.sh. kanë vërshtirësi për të folur, për të shikuar, për të dëgjuar ose kanë vështirësi për tu përqëndruar, mund të ndihmohen në kohën e duhur dhe me anë të kësaj mundësohet një fillim i mirë në kopësht dhe në shkollë.

Me qëllim për ti mbrojtur fëmijët nga sëmundje infektive të rrezikshme, kontrollohet rregullisht edhe mbrojtja me anë të vaksinimit.

Përdorni patjetër oferta të ndryshme për diktimin që në fillësë për të mirën e fëmijës tuaj!

## Për çfarë nevojitet fletorja e kontrolleve të fëmijës?

Në këtë fletore dokumentohen rezultatet e kontrolleve për diktimin që në fillësë.

Çdo nënë i dorëzohet një fletore e tillë e kontrolleve për fëmijën e saj, kur ajo largohet nga institucioni i lindjes.

Në rast të ardhjes nga jashtë shtetit ju do ta merrni fletoren nga pediatri dhe mjeku i të rinjve.

Fletorja e kontrolleve të fëmijës duhet të ruhet me kujdes dhe duhet ti paraqitet pediatri dhe mjekut të të rinjve tek çdo kontroll për diktimin që në fillësë.

## Çfarë është një Screening-ID dhe për çfarë përdoret ai?

Screening-ID (SC-ID) është një kod numerik anonim. Ai përbëhet nga një seri dymbëdhjetë shifrore me tre shifra kontrol li.

Që nga data 1 prill 2010 të gjithë të sapo lindur it marrin nga materniteti bashkë me fletoren e kontrolleve të fëmijës edhe një SC-ID fletë dokumentacioni (etiketa ngjitëse me etiketat barcode).

SC-ID përdoret për skanimin e të porsalindur it dhe për procedurën e ftesës dhe procedurën e përgjigjeve.